



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:260697

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05399805

**P.nr.332/23**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.K për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP.II.nr.1626/2023 të datës 27.11.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën prokurorisë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës me datë **29.02.2024**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë PP.II.nr.1626/2023 e datës 27.11.2023, për dhënien e urdhrit ndëshkimor – dënim me gjobë, andaj gjykata konform nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP), jep këtë:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

#### **I pandehuri:**

**A.Ki** lindur me datë ... ne I., ku dhe jeton në rr. “Gashi i Gurit” nr.21, nga i ati H., dhe e ëma M., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje te mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

Prej datës së pavërtetuar e deri me datë 17.12.2022, në rr. “Fadil Ferati” në Istog, pikërisht në lokalin “Ora Caffè” në lokalin e tij shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyre që, gjatë inspektimit nga zyrtarët e KEDS-it e kanë hasur njësorin elektrik pa bllomba distibutive dhe pas kontrollës së mëtutjeshme dhe hapjes së kapakut të njehsorit kanë vërejtur se i njëjti kishte

bërë bashkë fazat L1 në hyrje të njehsorit L2, ashtu që në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me çka kompanisë KEDS i ka shkaktuar në vlerë prej 1.361.92 euro.

- me këtë ka kryer veprën penale **vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 69 të KPRK-së, si dhe neneve 495 dhe 369 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

- I.** Ashtu që, të pandehurit **A.K** i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
  - Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguan dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet më dënim me burgim, ashtu që, për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do ti llogariten me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 5 ditë burgim.*
- II.** **URDHËROHET** i pandehuri A.K që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në afat prej 30 ditësh, të dëmtuarës Kompanisë “KEDS” Distrikti në Pejë, të i’ a kompensoj dëmin e shkaktuar me vepër penale, në shumë prej njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e dy cent (1.361.92 €).
- III.** **OBLIGOHET** i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV.** **Pala e dëmtuar:** KEDS, distrikti në Pejë, nuk udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, sepse me këtë aktgjykim i pandehuri është urdhëruar që të dëmtuarës të i’ a kompensoj dëmin e shkaktuar me vepër penale.

## A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1626/2023 të datës 27.11.2023, me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor – dënim me gjobë, kundër të pandehurit A.K për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 495 të KPP-së, dhe pranoi kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë ka vërtetuar se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, respektivisht provat materiale si:

- *Procesverbali i përpiluar nga zyrtaret e KEDS me numër 2100760 i datës 17.12.2022;*
- *Fatura e leshuar nga KEDS me nr. Dpehp2317947 e datës 05.01.2023;*
- *Fotografitë e vendit të ngjarjes ku shihet njëhësi elektrik dhe hapësirat e lokalit;*
- *Deklarata e të pandehurit A.K e dhëne në St. Policor në Istog, me datë 01.10.2023;*
- *Fatura e energjisë elektrike;*
- *Ekspertiza nga lëmia e Elektroteknikës e përpiluar nga eksperti ing.elektros Muhamet Shala mbi keqpërdorimin e shpenzimeve elektrike;*
- *Raporti informues i datës 01.10.2023.*

Janë prova të pranueshme dhe të besueshme, mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke bazuar në prova të lartcekura, vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nuk ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, nuk ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe se nuk ekzistojnë rrethana tjera të cilat e pengojnë ndjekjen penale.

#### Vendimi për dënimin plotësues

Gjykata duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 59 par.1, 2 nënpar.2.2 dhe nenit 61 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptoi dënimin plotësues, urdhrin për kompensimin e dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale, për faktin se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka rezultuar se shumica e dëmit e cila i është shkaktuar të dëmtuarës ka qenë e përcaktuar në tërësi në përshkrimin faktik të veprës penale dhe e bazuar edhe në Ekspertizën e Elektroteknikës e punuar në këtë çështje penale nga eksperti ing.elektros Muhamet Shala.

#### Shpenzimet e procedurës

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës u mor konform nenit 450 të KPP-së, ndërsa vendimi për pagesën për fondin për kompensimin e viktimave të krimit u mor konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

#### Kërkesat pasurore-juridike

Meqenëse me dënimin plotësues si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është urdhëruar që palës së dëmtuar në tersi t'i bëhet kompensimi i dëmit të shkaktuar nga i pandehuri me vepër penale i përshkruar në përshkrimin faktik të veprës penale. Si dhe pala e dëmtuar nuk kishte parashtruar në gjykatë ndonjë kërkesë tjetër pasurore pas ngritjes së aktakuzës, andaj si rrjedhojë nuk u udhëzua në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 495 dhe 369 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Petrit Nrecaj**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi me urdhër ndëshkimor, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim dhe të propozojnë prova në dobi të mbrojtjes, në këtë Gjykatë.